



GJYKATËS KOMERCIALE NË PRISHTINË
-Departamenti Për Çështje Ekonomike-

PADITËSI: Komuna e Vushtrisë, Rruga "Isa Boletini" nr.10, të cilën e përfaqëson kryetari i komunës Ferit Idrizi.

E PADITURA: Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, me seli në adresën – Rruga "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë

P A D I

Për kompensim të dëmit për shkak të implementimit të kontratës kolektive

Vlera e kontestit 1,920,488.00 euro

A. ARGUMENTET LIDHUR ME KUSHTET LIGJORE - RRJEDHA E PROCEDURËS DERI TE PADIA.

1. E paditura – Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (tani e tutje: MASHTI) më dt. 18.04.2017 ka nënshkruar kontratën kolektive me SBASHK-un.

Provë : kontrata kolektive e dt. 18.04.2017

2. Me kontratën kolektive palët nënshkruese (MASHTI & SBASHK-u) janë dakorduar që në mbështetje të Legjislacionit të Arsimit Parauniversitar dhe Universitar kanë përcaktuar të drejta të posaçme dhe obligimet e të punësuarve në institucionet publike dhe private në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, shkollave speciale e atë universitar e publik dhe të drejtat dhe obligimet e palëve nënshkruese (neni 1 i kontratës kolektive). Gjithashtu palët kontraktuese kanë paraparë se dispozitat e kontratës janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat, DKA, KD të universiteteve e institucioneve të Arsimit të lartë, MASHTI, etj - neni 2 par.1.2 i kontratës kolektive).
3. Ndërsa në nenin 35 par.5, 7, 8, 9 dhe 10 të kontratës kolektive të Arsimit janë paraparë benefite për punëtorët e Arsimit siç janë: shpenzimet e rrugës 70% , shpenzimet për ushqim gjatë ditëve të punës (2 euro), shpërblimet jubilarë, pagat përcjellëse, shkalla e inflacionit.

Provë : Kontrata kolektive, neni 35.

4. Kurse me nenin 46 par.1 dhe 2 të kontratës në fjalë, palët nënshkruese ndër të tjera janë zotuar se bashkarisht do të angazhohen për t'i informuar dhe ndihmuar komunat për planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të neni 35 par.5, 7 dhe 9 të kontratës, kurse në nenin 46 par.2 palët kontraktuese janë zotuar se bashkarisht do të angazhohen tek Ministria e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm, ndërsa fare nuk e definojnë nenin 7 të kontratës kolektive përkitazi me licencimin e mësimdhënësve, i cili nen ka kosto shumë të lartë financiare për komuna. Deri më sot, asnjëra palë kontraktuese (MASHT-i dhe SBASHK-u) nuk i kanë kryer obligimet kontraktues-financiare ndaj komunës sonë e as që janë angazhuar tek Ministria e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 par.5, 7 dhe 9.

Provë: Neni 46 i kontratës kolektive si më sipër
dëgjimi i palëve.

5. Ne si paditës edhe përkundër faktit se nuk jemi nënshkrues të kontratës kolektive të Arsimit, e as që jemi pyetur për nënshkrim të saj , i vuajmë pasojat financiare të kontratës në fjalë (ka pasur zvogëlim të të hyrave dhe dëm financiar). Vetëm gjatë vitit 2020 për obligime ndaj mësimdhënësve dhe personelit arsimor (për shujta, shpërblime jubilarë, shpenzime të rrugës e paga përcjellëse), në mënyrë të dhunshme përmes aktgjykimeve gjyqësore apo përmbaruesve privat paditëses - komunës së Vushtrrisë i janë marrë nga buxheti vetanak shuma prej 1,410,488.00 euro (Një milion e katërqind e dhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro) për vitin 2020, kurse në vitin 2021- 517,619.00 euro (pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë euro). Kurse kostoja financiare për vitin 2022 si rezultat i implementimit të kontratës kolektive ende nuk dihet, sepse kontestet gjyqësore janë në proces , por nëse vazhdon ky trend do të rrezikohet funksionimi normal i komunës dhe organeve të saja.

Provë: pasqyrat financiare të drejtorisë së financave pranë paditëses për vitin 2020-2021.

6. Paditësja Komuna e Vushtrrisë, më datë 10.06.2022, përmes parashtrësës 02.Nr.779/22 i drejtohet të paditurës MASHTI-t me kërkesë që e paditura të bëjë rimbursimin (kompenzimin) e mjeteve financiare për vitin 2020-2021 në llogari të paditëses - komunës së Vushtrrisë, sepse e paditura e ka obligim kushtetues dhe ligjor që me mjete të veta financiare t'a bëjë implementimin e kontratës kolektive si më sipër.

Provë: Parashtrësja në fjalë

7. E paditura MASHTI, përmes parashtrësës së datës 12.07.2022 me nr.ref.1332, i kthen përgjegje paditëses, komunës së Vushtrrisë, ku e informon paditësen se nuk do ta bëjë rimbursimin e mjeteve materiale si pasojë e implementimit të kontratës kolektive si më

sipër, me pretekst se rimbursimi – pagesa e stafit menaxherial dhe personelit tjetër arsimor nuk është kompetencë e të paditurës-MASHTI-t ,por e komunave , ndërsa nuk e konteston shumën dhe lartësinë e mjeteve financiare që ka paguar paditësja-komuna e Vushtrrisë për punëtorët e arsimit për vitin 2020-2021 .Gjithashtu e paditura përmes parashtresës në fjalë propozon që edhe më tutje të respektohet kontrata kolektive si më sipër.

Provë: Parashtresa e MASHTI-t

B. SHKELJET LIGJORE NGA ANA E TË PADITURËS

1. Kushtetuta e Kosovës
2. Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale .
3. Ligji për Vetëqeverisje Lokale.
4. Ligji Nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal.
5. Ligji Nr. 03/L-068 Për Arsimin në Komuna Të Republikës së Kosovës.

-
1. E paditura –MASHTI, me rastin e nënshkrimit të kontratës kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, ku janë paraparë benefite për punëtorët e arsimit siç parashihen në nenin 35 par.5, 7, 8, 9 dhe 10 të kontratës kolektive të arsimit siç janë: shpenzimet e rrugës 70% , shpenzimet për ushqim gjatë ditëve të punës (2 euro), shpërblimet jubilarë, pagat përcjellëse, shkalla e inflacionit si dhe pagesa për licencim, ndërsa ka obliguar komunat për implementim të kontratës kolektive, ka bërë shkelje të nenit 124 par. 3 dhe 5 të Kushtetutës së Kosovës. Sipas nenit 124 par.3 të Kushtetutës citat "Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon **shpenzimet** për ushtrimin e delegimit", kurse sipas nenit 124 par.5 të Kushtetutës citat "Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin". Pra nga përmbajtja e dy neneve të Kushtetutës rezulton se e paditura MASHTI me rastin e obligimit të (kundërligjshëm dhe kundërkushtetues), komunave për implementimin e kontratës kolektive (implementimi ka kosto milionëshe), ka qenë dashur që koston financiare të implementimit të kontratës kolektive të Arsimit ta përballojë me mjete të veta financiare e jo t'i obligojë komunat, respektivisht mjetet financiare për implementimin e kontratës kolektive të dt. 18.04.2017 t'ua bartë në llogari komunave.

Provë : e pakontestueshme

2. E paditura- MASHTI , me rastin e nënshkrimit të kontratës kolektive e arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, ka bërë shkelje të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (Kushtetuta në paragrafin 3 të nenit 123, kërkon që veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale të respektojë Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, ndërsa po i njejtë paragraf thekson se Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale) dhe atë paragrafi 6 i nenit 4 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, (përcakton që duhet t'u kërkohe mendimi autoriteteve lokale, brenda mundësisë në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për të gjitha

çështjet që u përkasin atyre drejtpërsëdrejti), ndërsa e paditura asnjëherë nuk ka marrë mendim nga ana e paditëses përkitazi me nënshkrimin e kontratës kolektive si më sipër.

Provë : e pakontestueshme

3. E paditura me veprimet e saja kur ka obliguar komunat për implementim të kontratës kolektive ka bërë shkelje të nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi (h) i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (arsimi publik parashkollor, fillor dhe i mesëm është kompetencë ekskluzive e Komunave), sepse Ligji në fjalë askund nuk parasheh se Komuna duhet të bëjë pagesa për shujta, paga jubilare, paga përcjellëse, pagesa për licenca e për inflacion, siq pretendon e paditura në parastresën e dt.12.07.2022.

Provë : e pakontestueshme

4. E paditura- MASHTI me rastin e nënshkrimit të kontratës kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, ka bërë shkelje të nenin 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (ka shkelur pavarësinë financiare të komunave). Neni 4 i Ligjit në fjalë parasheh citat "Parimi i pavarësisë financiare të komunave do zbatohet kundrejt financimit dhe zbatimit të kompetencave vetanake komunale; megjithatë financimi dhe ushtrimi i këtyre kompetencave duhet të bëhet në të mirë të popullsisë së komunës dhe në përputhje me standardet dhe kushtet e aplikueshme për këto kompetenca të përcaktuara me ligj", kurse neni 5 i Ligjit të apostrofuuar parasheh citat "Kur Qeveria i delegon një kompetencë një ose më shumë komunave; këto komuna aq sa është e mundshme, mund ta përshtatin ushtrimin e këtyre kompetencave me kushtet lokale. Komuna duhet t'i ofrojë shërbimet të cilat rrjedhin nga një kompetencë e deleguar në mënyrë të hapur dhe të barabartë. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që në BKK komunave t'u ofrohen fondet e nevojshme për ushtrimin e kompetencave të deleguara; këto fonde duhet të jenë në një nivel të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme të komunës të bëra në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave", ndërsa neni 6 i Ligjit në fjalë parasheh-citat "Kur një ligj u jep kompetenca të shtuara vetanake një grupi të caktuar të komunave (kompetencat e "shtuara" vetanake), këto kompetenca të shtuara duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë me kompetencat e tjera vetanake. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që në BKK, komunave përkatëse t'u ndahen fondet e nevojshme për ushtrimin e këtyre kompetencave. Nëse në kuadër të një kompetence të shtuar parashihet ofrimi i një shërbimi publik, fondet e ndara për komunën duhet të jenë të mjaftueshme për t'i lejuar komunës ofrimin e këtyre shërbimeve në përputhje me standardet minimale të cilësisë dhe sasisë, të cilat janë përcaktuar në rregullat përkatëse të autoritetit qendror publik i cili është përgjegjës për ofrimin e këtyre shërbimeve në Kosovë; dhe këto fonde duhet të ndahen në një nivel të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme të komunës të bëra gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave". Nga përmbajtja e neneve të apostrofuara të Ligjit në fjalë rezulton se e paditura ka qenë e obliguar që me mjete të veta t'i mbulojë shpenzimet lidhur me implementimin e kontratës kolektive të arsimit si më sipër apo t'i ndajë fonde komunës tonë (paditëses) për implementim të kontratës në fjalë.

Provë: e pakontestueshme

5. E paditura me rastin e nënshkrimit të kontratës kolektive ka shkelur Ligjin Nr. 03/L-068 Për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, sepse në nenin 5 të Ligjit në fjalë tek kompetencat e komunave shkronja f) parashihet që komuna është përgjegjëse për pagesën e stafit menaxherial si dhe të personelit tjetër të punësuar në pajtim me legjislacionin e Kosovës, ndërsa askund dhe me asnjë nen të ligjit në fjalë nuk parashihet pagesa e arsimtarëve dhe personelit tjetër arsimor për shujta, paga jubilarë, paga përcjellëse, pagesa e licencave e inflacioni. Ndërsa po i njëjti ligj nuk përmban asnjë dispozitë ligjore me të cilën e paditura ka të drejtë t'i obligojë komunat për një gjë të tillë. Pra e paditura-MASHTI, ka bërë tejkalim të kompetencave të saja dhe ndërhyrje kundërligjore në kompetenca të komunave.

Provë : e pakontestueshme

6. Të gjitha shkeljet arbitrare të sipërtheksuara që janë bërë nga ana e të paditurës ndaj komunave, përkitazi me kompetencat vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara si dhe shkeljes së Parimit të pavarësisë financiare të komunave, konstatohen edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Nr.ref:AGJ 1977/22 në rastin nr.KO145/21 -parashtrues komuna e Kamenicës, i publikuar në prill 2022.

Provë : Aktgjykimi i sipërtheksuar i cili mund të gjindet në web-fq.e Gjykatës Kushtetuese

C. DËMI I SHKAKTUAR.

Konform Ligjit mbi Marrëdhëniet detyrimore, parashtrorj kërkesë për kompensimin e dëmit të pësuar material, pavarësisht që nga ajo se a është shkaktuar me qëllim ose nga pakujdesia e të paditurës. Me veprimet e tilla të cekura si më lartë, e paditura i ka shkaktuar dëme të pariparueshme materiale dhe jomateriale paditëses, stafit të saj menaxherial dhe qytetarëve të komunës së Vushtrisë (qytetarët e komunës janë privuar nga shumë projekte të parapara nga paditësja e të cilat projekte nuk janë realizuar si rezultat i inkasimit të dhunshëm të mjeteve materiale nga ana e gjykatave e përmbartues privat përkitazi me implementimin e kontratës kolektive si më sipër). Për këtë shkak e paditura obligohet ligjërisht që ta bëjë kompensimin në të holla të tërë dëmit që ia ka shkaktuar paditëses dhe subjekteve tjera që kanë interes në këtë proces. Kjo mbështetjen ligjore e ka në LMD e cila e përkufizon: *dëmin si zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëmi i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo-material)*. Ligji i tillë njëherit e parasheh edhe të drejtën për kërkesë lidhur me kompensimin e shpërblimit të dëmit që do të vazhdojë në të ardhmen, gjë që paditësi e kërkon që këtë ta bëjë eksperti financiar që do të angazhohet për ekspertizë financiare-përcaktimin e dëmit material që ka pësuar paditësi.

D/a . DËMI MATERIAL

- Sipas përlllogaritjeve të kalkuluara nga paditësja dëmi material është si vijon:
- 1,410,488.00 euro (Një milionë e katërqind e dhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro) për vitin 2020.
- 512,561.17 euro (pesëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një e shtatëmbëdhjetë euro), për vitin 2021.

D/b. DËMI JOMATERIAL

Për shkak të veprimeve të kundërligjshme, diskriminuese të të paditurës, paditëses- komunës së Vushtrrisë, ju meren mjete financiare nga kategoria e investimeve kapitale dhe nga fondet burimore të tjera (ku për pasojë dëmtohen qytetarët e komunës sepse për shkak të inkasimit të dhunshëm të mjeteve financiare nga ana e gjykatave apo përmbaruesve privat të njejtit privohen nga projektet e tyre të parapara me buxhet komunal siq janë: rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, hapja dhe mirëmbajtja e kanalizimeve, zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ndriqimit publik , zgjerimi dhe mirëmbajtja e ujësjellëit , ndërtimi i shkollave dhe mirëmbajtja e tyre etj.) që në instancë të fundit në fundvit jo vetëm që dëmtoheni në planin buxhetor, por edhe gjatë auditimit të pasqyrave financiare marrim **titullin e kualifikuar**, që do të thotë që me vite të tëra nuk mund të marrim grante qeveritare .

E. PROPOZIM

Me qëllim të përcaktimit të lartësisë së dëmit të shkaktuar material dhe jomaterial, të cilin e paditura ia ka shkaktuar paditëses, i propozoj gjykatës që EX OFFICIO të angazhoj një ekspert financiar i cili përmes ekspertizës së tij do ta përcaktonte lartësinë e dëmit që e ka pësuar paditësja.

F. LISTA E PROVAVE QË I BASHKANGJITEN PADISË:

1. Kontrata kolektive e Arsimit
2. Pasqyrat financiare të drejtorisë së financave
3. Parashtrësja 02.Nr.779/22 e dt.10.06.2022
4. Parashtrësja e MASHTI-t dt.12.07.2022 me nr.ref.1332
5. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Nr.ref:AGJ 1977/22 në rastin nr.KO145/21, i cili mund të shkarkohet në web-fq.e Gjykatës Kushtetuese.

G. PROPOZIM PËR VENDOSJE

Kërkojmë nga Gjykata komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike që të caktoj seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të fakteve-provave të nxjerrë këtë:

A K T G J Y K I M

1. APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditëses - Komunës së Vushtrisë, si e bazuar.
2. DETYROHET E PADITURA që nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, t'ia kompenzojë tërë dëmin e shkaktuar paditëses (dëmin material dhe jomaterial në lartësi që e përcakton eksperti financiar), me kamatë ligjore (konform legjislacionit në fuqi duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit).
3. OBLIGOHET E PADITURA që t'i përmbushë të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e përfaqësuesit të paditëses.

Vushtri, më 26.07.2022



Paditësi,

Ferit Idrizi
Ferit Idrizi-Kryetar i komunës